



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5868/ Prot.

Rrëshen më, 20. 11. 2025

P/V E N D I M

Nr. 101 datë 20. 11. 2025

PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE VENDORE PËR VITIN 2026
BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të nenit nr. 8 pika 2, nenet 34 dhe 54 shkronja f të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” (i ndryshuar), ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar), ligji nr. 8378 datë 22.07.1998 “Kodi rrugor në RSH” (i ndryshuar), VKM nr. 132 datë 07.02.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa” e bazës së taksës për kategori specifike, nenit 128 të ligjit 8485, ligjit 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 32 datë 31.12.2013 të Ministrit të Financave “Për miratimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, udhëzimit nr. 15 datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor”, udhëzimin nr. 5627 datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionin për lëshimin e certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit” (i ndryshuar), ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar), VKM nr. 607 datë 29.07.2020 “Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, legjislacionit të aplikueshëm në fuqi, akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të

sipërcituara, pas dëgjësive publike në çdo njësi administrative të Bashkisë Mirditë dhe shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me drejtoritë e tjera si operatorë ndihmës, me paraqitjen e projekt vendimit të Kryetarit të Bashkisë, pas shqyrtimit në mbledhjen e komisionit të ekonomisë, për ta kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve:

V E N D O S I

Të miratojë Paketën Fiskale Vendore për vitin 2026 të Bashkisë Mirditë si vijon:

A. TAKSAT VENDORE

Taksat vendore mbështeten në ligjin 9632 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar). Këto taksa janë të përcaktuara me VKM dhe menaxhohen dhe kontrollohen nga Kadastra Fiskale. Në zërin e taksave vendore përfshihen:

1. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme
2. Taksa e fjetjes në hotel
3. Taksa e ndikimit në infrastrukturë
4. Taksa mbi kalimin e të drejtave të pronësisë
5. Taksa e tabelës
6. Taksa të përkohshme (në rast se shihet e arsyeshme të vendoset)

A1. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksa e pasurisë së paluajtshme përbëhet nga

A.1.1 Taksa e ndërtesës

A.1.2 Taksa e truallit

A.1.3 Taksa e tokës bujqësore

Kësaj takse i nënshtrohen të gjithë personat fizik, juridik, familjar vendas ose të huaj, të cilët janë pronar të pasurive në Republikën e Shqipërisë pavarësisht nga niveli i shfrytëtimit të tyre, ose përdorues që e shfrytëzojnë maksimalisht pasurinë. Sipërfaqja e ndërtesës në përdorim apo pronësi, përcaktohet nga dokumentacioni që vërteton përdorimin ose pronësinë e saj. Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i pasurisë ka të drejtë të bëjë një vetëdeklarim të sipërfaqes që përdor pranë Bashkisë

Mirditë, e cila më pas ka të drejtë të ngrejë një komision me specialitë të fushave të caktuar për matjen faktike në terren të sipërfaqes përkatëse që përdoret dhe shfrytëzohet për biznes ose nga familjarë.

A.1.1 Taksa e ndërtesës

Ndërtesë është objekti mbi ose nën sipërfaqen e tokës që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një apo më shumë njësi pronësore që është objekt i taksueshëm si taksë pasurie ndërtesë.

Taksa e ndërtesës është e përcaktuar me VKM dhe llogaritet në bazë të metrave katror të sipërfaqes. Nëse ndërtesa është më shumë se 1 kat, llogaritja bëhet për sipërfaqen e çdo kati. Ndërtesat kanë nivel takse të ndryshme për banim, biznes apo kategori të tjera. Taksa e ndërtesës paguhet nga individi/subjekti që e shfrytëzon atë.

Sipas VKM nr. 132 çmimi referues për metrat katrorë të banesave është 42,000 lekë për Njësinë Administrative Rrëshen dhe 29,500 lekë për Njësinë Administrative Rubik. Për të gjitha njësitë e tjera, sipas VKM për taksën e pasurisë, çmimi referues është sa çmimi i njësisë më të afërt (njësia më e afërt është njësia Rrëshen).

- Ndërtesa banimi konsiderohen të gjithë ato ndërtesa të cilat përdoren nga qytetarët vetëm për qëllime banimi dhe jo me qëllim fitimprurës, ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit që nuk janë të shitura, por janë të hipotekuara si ndërtesa banimi.

- Ndërtesa për tregti dhe shërbime konsiderohen ato ndërtesa që shfrytëzohen nga pronarët e tyre për qëllime fitimprurëse që ushtrojnë aktivitete private në fushën e tregtisë (industrial ushqimor, fruta-perime etj), në fushën e shërbimeve (agjenci bankare, këmbim valutor, doganor, hoteleri-turizëm familjar, palestra e fitnes, pishina, pika shitje karburanti, farmaci, klinika, spitale, agjenci, salla të ndryshme etj. të ngjashme), profesioneve të lira (avokat, noter, marangoz, riparime, parukeri etj.).

- Ndërtesa për prodhim konsiderohen ndërtesat për prodhime, magazinime dhe përpunime të mallrave industriale ose ushqimore si depo, magazina etj të ngjashme me to.

- Ndërtesat për parkim ndahen në ndërtesa për parkim të mbuluar (ambjentet e mbyllura ose parkimet nëntokësore) dhe për parkime të hapura (në ambjente të hapura).

- Ndërtesat për bujqësi dhe blegtori konsiderohen stallat e bagëtive, magazinat e ruajtjes së produkteve bujqësore dhe blegtorale, bimëve medicinale etj.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat aplikohet si përqindje e bazës së taksës dhe është:

0,05% e ndërtesës shfrytëzohet për banim

0,2% shfrytëzohet për veprimtari ekonomike

30% e shkallës së taksës përkatëse e gjithë sipërfaqes ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur të përfundojë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Metodologjia për përcaktimin e vlerës së ndërtesës:

- Vetëdeklarimi (çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e paluajtshme që në përdorim dhe e shfrytëzon si pronë).
- Përcaktimi i çmimit të vlerësuar dhe i sipërfaqes së ndërtesës bazohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme të mbajtur nga zyrat vendore ZVRPP.
- Kur vlerësimi i pikave më lart është i pamundur, çmimi për vlerësimin e pasurive të paluajtshme do të korrespondojë me çmimin mesatar referues të ndërtesave që përdoret për qëllime banimi sipas zonës.
- Nëse taksapaguesit nuk paraqiten në njësitë e qeverisjes vendore për të deklaruar sipërfaqen e pasurisë ose nga verifikimi në terren nuk sigurohet informacioni i saktë i ndërtesave të identifikuar, njësia bën vetë vlerësimin e sipërfaqeve me 100m² për njësi pronësore për ndërtesat për banim dhe 70m² për sipërfaqe të privatizuara me ligjin 7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” të ndryshuar.

Mëposhtë paraqiten të dhënat për lekë/m² për sipërfaqe të ndërtesave sipas kategorive:

Nr	Kategoria e ndërtesës	Njësia Rrëshen	Njësia Rubik
1	Ndërtesa banimi	21	14.75
2	Ndërtesa për tregtim dhe shërbime	126	88.5
3	Ndërtesa për parkim të mbuluar dhe bodrume	58.8	41.4
4	Sip ndërtimi për parking të hapur	25.2	17.7
5	Sip ndërtimi për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim, magazinim, fabrika, depo, magazina	42	29.5
6	Sip ndërtimi për bujqësi dhe blegroti apo veprimtari mbështetëse	25.2	17.7
7	Ndërtesat e privatizuara me ligjin 7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” të ndryshuar,	58.8	41.3
8	Për ndërtesa në proces ndërtimi, të cilat kanë tejkaluar afatin e lejes së ndërtimit	30% e zërit përkatës të taksës	

Sipas VKM nr. 132, përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- Pronat e shtetit dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore që përdoren për qëllime jofitimprurëse
- Pasuritë në pronësi të shtetit të kaluara me VKM në administrim të shoqërive publike shtetërore
- Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të liberalizuara
- Banesat sociale në pronësi të bashkisë

-Pasuritë e paluajtshme pronë e subjekteve fizike ose juridike që me marrëveshje me bashkinë përdoren si banesa sociale

-Ndërtesat në funksion të veprimtarive fetare

-Hotelet ose strukturat akomoduese me 4 yje me status social sipas ligjit të turizmit dhe që janë markë tregtare e regjistruar dhe e njohur ndërkombëtarisht "brand name"

-Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve me pension pleqërie ose pension social, kur familjet e tyre përbëhen vetëm nga personat që përfitojnë pensionin ose kanë në ngarkim fëmijë të paafte për punë.

-Ndërtesat e banimit për kryefamiljarët që trajtohen me ndihmë ekonomike

-Ndërtesat kulturore të mbrojtura, për periudhën në të cilën deklarohet mbrojtja sipas ligjit në fuqi për monumentet e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës së ndërtesës është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave.

A.1.2 Taksa e tokës bujqësore

Tokë bujqësore është toka e përcaktuar me këtë emërtesë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurive. Bazë e taksueshme e tokës bujqësore është sipërfaqja në hektar, në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja përcaktohet në bazë të dokumentacionit që e vërteton atë (dokument pronësie, çertifikatë e regjistrimit të tokës). Në rast të mungesës së dokumentacionit kur kryefamiljari taksapagues është vetëm përdorues i tokës bujqësore, sipërfaqja bazohet në vetëdeklarimin e bërë në njësitë e qeverisjes vendore. Për vërtetësinë e deklarimit mban përgjegjësi deklaruesi dhe verifikimet kryhen në terren nga organet kompetente të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Niveli i taksës për tokën bujqësore llogaritet si lekë/hektar.

Kategoritë e tokës	Niveli i taksës (lekë/ha)
Klasa I	1400
Klasa II	1200
Klasa III	1100
Klasa IV	1000
Klasa V	900
Klasa VI	800
Klasa VII	700

Toka bujqësore në Bashkinë Mirditë i përket klasës së VII në vlerën prej 700 lekë/ha.

Në rastet kur toka bujqësore e një taksapaguesi është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore, jepet lehtësim ose përjashtim i përkohshëm, kohëzgjatja e të cilit përcaktohet nga Këshilli Bashkiak deri në 75% të vlerës në raport me dëmin e shkaktuar.

Nga taksa e tokës bujqësore përjashtohen:

-Sipërfaqet që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për 5 vitet e para.

-Toka bujqësore e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore në masën 75% e vlerës së taksës për sipërfaqen e dëmtuar.

Përgjegjëse për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave.

A.1.3 Taksa e truallit

Truall është sipërfaqja e tokës jobujqësore që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumentave ligjore të planifikimit e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja në metër katror në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja përcaktohet në bazë të dokumentacionit të pronësisë apo vetëdeklarimit në rast se taksapaguesi është vetëm përdorues. Përgjegjësia për vërtetësinë e deklarimit është e taksapaguesit dhe njësia e qeverisjes vendore përkatëse ka të drejtë të verifikojë në terren vërtetësinë e deklaratës. Niveli i taksës përcaktohet në lekë/m². Sipas kategorizimeve të bashkive të bëra me ligjin në fuqi për taksën e pasurisë, për Bashkinë Mirditë taksa e truallit është në masën:

-0,12 lekë/m²/vit për qëllime banimi

-12 lekë/m²/vit për qëllime biznesi

Detyrimi i truallit për qëllime biznesi llogaritet në bazë të sipërfaqes së ndërtesës së aktivitetit deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë.

Për vjeljen e kësaj taksa ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave.

A2. Taksa e fjetjes në hotel

“Hotel” quhet çdo veprimtari që jep strehim dhe akomodim kundrejt pagesës. Struktura akomoduese përfshijnë kategoritë si psh: hotel, motel, pension, bujtina, shtëpi pritje për turizëm familjar dhe çdo lloj objekti që përdoret për këtë qëllim. Taksa e fjetjes në hotel llogaritet në bazë

të numrit të netëve të qëndruara në strukturat akomoduese për çdo person dhe paguhet në lekë/natë qëndrimi në hotel. Verifikimi i numrit të netëve përcaktohet në bazë të regjistrimeve në regjistrin e mbajtur në recepsionin e çdo lloj strukture akomoduese.

Detyrimi i taksës i takon klientit që akomodohet në hotel dhe mbahet nga hoteli për llogari të njësisë së qeverisjes vendore. Sektori përkatës faturon hotelin sipas regjistrit të mbajtur nga këta të fundit, duke pasqyruar çmimin e fjetjes dhe vlerën e taksës. Çdo strukturë akomoduese që përfshihet në këtë lloj takse duhet të bëjë raportimet brenda datës 10 të çdo muaj pasardhës qoftë dhe nëpërmjet emailit. Dorëzimi i librit duhet të bëhet dorazi pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim taksave 2 herë në vit dhe të bëhen rakordimet sipas deklarimeve mujore nëse janë të njëjta apo jo dhe të bëhet taksimi.

Në rastet kur strukturat akomoduese nuk paraqesin asnjë lloj dokumentacioni për të dhënat e netëve të fjetjes në hotel, ose në rastet kur ka mospërputhje të të dhënave mujore me konstatimet në terren, Bashkia Mirditë me drejtorinë përkatëse ka të drejtë të bëjë vlerësim alternativ duke marrë për bazë numrin e dhomave që subjekti shfrytëzon për akomodim me një numër minimal prej 2 persona për çdo dhomë.

-Hotel me 4 ose 5 yje 122.5 lekë/natë qëndrimi

-Çdo strukturë tjetër akomoduese 49 lekë/natë qëndrimi

Struktura për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave.

A3. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Taksa e ndikimit në infrastrukturë përcaktohet sipas ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes për . Vlerat si investim i ri përcaktohen në përputhje me ligjin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit. Niveli i taksës sipas kategorive është si mëposhtë vijon:

a) Ndërtime nga shoqëritë e ndërtimit për qëllime banimi që nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 3% e çmimit të shitjes për m².

b) Ndërtime nga shoqëritë e ndërtimit për qëllime tregtimi, që nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 4% e çmimit të shitjes për m².

c) Ndërtime nga shoqëritë e ndërtimit për qëllime shërbimi, që nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 5% e çmimit të shitjes për m².

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave" që miratohet çdo vit.

d) Në rastet e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe për Bashkinë Mirditë është deri në 3% e saj dhe konkretisht:

d/1. Ndërtime me funksion prodhim, përpunim dhe ruajtje produktesh bujqësore dhe blegtorale, 1% e vlerës së investimit.

d/2. Ndërtime me funksione për industrinë prodhuese dhe përpunuese etj të ngjashme, 3% e vlerës së investimit.

d/3. Objekte me përdorim në sektorin e turizmit, 1% e vlerës së investimit.

e) Për ndërtimet e rrugëve kombëtare, porteve, aeroporteve, tuneve, digave, infrastruktura në energji dhe projekte të ngjashme, përfshirë dhe paisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.1% e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto është e përfshirë në preventivin e investimit.

f) Për ndërtesat në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0.5% e vlerës së investimit. Detyrimi për taksën i përket investitorit. E ardhura nga taksa mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit.

g) Për punime që kryhen në zbatim të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar neni 6, për ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisje me leje ndërtimi, lëshohet autorizim punimesh me një vlerë prej 2000 lekë.

h) Për punime që kryhen në zbatim të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar neni 7, punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh me një tarifë aplikimi me vlerë 5000 lekë. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit.

-Taksa paguhet brenda 15 ditëve nga data e njoftimit për vlerësimin pozitiv të vendimit për miratimin e lejes për punime dhe lëshimin e autorizimit për pagesë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Në rast se pagesa nuk kryhet brenda afateve të caktuara, llogaritet kamatëvonesë prej 0.2% e shumës që duhet të paguajë deri në 30 ditë punë. Nëse pagesa nuk kryhet as pas 30 ditësh nga llogaritja e kamatëvonesës, vendosen masa të tjera nga Kryetari i Bashkisë deri në revokimin e lejes.

-Për kategoritë ku niveli i taksës aplikohet mbi vlerën e investimit, në përfundim të punimeve të kryera sipas lejes së miratuar, bëhet kontrolli i pagesave me situacionin përfundimtar të objektit nga DPZHT në bashki. Nëse ka diferenca mes vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar

dhe preventivit, njoftohet subjekti për vlerën e diferencës që është i detyruar të shlyejë. Mosshlyerja e detyrimit, përbën shkak për pezullimin e procedurave të pajisjes me certifikatë përdorimi të subjektit.

Stuktura përgjegjëse për ndjekjen e hapave për taksën e ndikimit në infrastrukturë është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit. Kjo drejtori ka detyrim ligjor të përcjellë informacionin për pagesat dhe të koordinojë me Sektorin e Tatim-Taksave nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik që bën faturimin në bazë të autorizimeve të punimeve të lëshuara.

A.3.1 Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale

- Çdo subjekt privat që aplikon leje zhvillimi dhe ndërtimi për sipërfaqe ndërtimore me qëllim banimi mbi 2000 m², siguron kalimin pa shpërblim të një apartamenti me sipërfaqe 80-90 m² me kushtet e një strehimi të përshtatshëm në favor të fondit publik të banesave sociale. Në rast se kjo sipërfaqe nuk mund të jepet në sipërfaqen ndërtimore që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe ndërtimore tjetër. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në ZRPP.

- Nëse një subjekt që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese, për efekt përfitimi, kërkon rritje të intensitetit të ndërtimit në përputhje me standardet e miratuara në planin vendor dhe vetëm atëherë kur bashkia ka miratuar një plan vendor, atij mund ti akordohet shtesa në intensitetin përkundrejt përfitimit të një sipërfaqe ndërtimi në favor të bashkisë për strehim social sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

- Në raste të zbatimit të një projekti të veçantë për efikasitetin e energjisë urbane, shihet nëse projekti është zbatuar me përpikmëri, dhe vetëm atëherë subjekti rimbursohet taksa e paguar mbi nivelin minimal të përcaktuar me ligj.

Përfshihen nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë:

-Investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese me status "Hotel/Resort" me 5 yje sipas përcaktimit në legjislacionin fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të markës tregtare të njohur ndërkombëtare dhe janë "brand name".

-Investime të subjekteve që zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm" sipas ligjit të turizmit.

-Investimet për rindërtimin, restaurimin, riparimin e ndërtesave për qëllime banimi të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore sipas legjislacionit për mbrojtjen civile. Dokumentacioni plus kërkesës që paraqitet për përjashtimin nga taksa, është i përcaktuar me VKM.

-Investimet në kuadër të rindërtimit për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

-Në rastet kur investitor është vetë bashkia, nuk aplikohet taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Të gjithë investitorët do të pajisen me lejen e ndërtimit pranë bashkisë vetëm pasi të kenë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe taifën e çastrimit për kantierin e ndërtimit. Për ndërtimet me sip. mbi 2000 m² përveç shlyerjes së detyrimeve të mësipërme, duhet të kenë nënshkruar dhe kontratën me bashkinë për fondin e banesave sociale.

Të gjithë individët, persona fizik apo OJF etj, do të pajisen me deklaratën paraprake të punimeve, vetëm pasi të kenë paguar tarifën e pastrimit për kantierin e ndërtimit.

A4. Taksa e tabelës

Taksa e tabelës bazohet në ligjin 106/2017 për disa ndryshime në ligjin 9632 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 8, aneksi 7 “Taksa e tabelës sipas kategorive të bashkive”.

Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet që vendosin tabela të lëvizshme apo të palëvizshme për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose tabela për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre ose për të tretë. Tabela mund të vendoset në pamjen ballore të veprimtarisë ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë.

- Tabelë për qëllime identifikimi quhet tabela brenda apo jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti që nuk përdoret për reklamimin e të tretëve. Në tabelat identifikuese ballore vendoset emri dhe/ose loji i aktivitetit të kompanisë. Tabelat që vendosen jashtë territorit janë në formën dhe përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.

- Tabelë për qëllime reklamimi janë të gjitha tabelat me pamje joballore të vendosura në tarraca, llozhe, ballkone etj të ngjashme që kanë përmbajtje reklamimi për vete ose për të tretë. Tabelat reklamuese mund të jenë statike, ndriçuese ose jo, faqet murale, adezivet reklamuese, pamjet 2 ose 3 vizionshe, elektromagnetike me ose pa ndriçim, reklammat dixhitale, me gjithë elementët gjysëm-përçues etj.

- Tabela reklamimi në funksion apo ekspozime të ndryshme të hapura do të kuptojmë të gjitha tabelat në funksion të panairove të ndrysh, e që kanë si qëllim reklamimi për vete ose të tjerët. Këto tabela miratohen nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pas kërkesës së bërë nga subjekti, dhe një kopje e lejes i shkon Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik për faturimin e tabelës reklamuese sipas ligjit.

(Taksa e tabelës paraqitet sipas imazhit të bashkangjitur në aneksin 1 në fund të paketës fiskale. Marrë në anekset e ligjit nr. 9632 datë 30.11.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave”)

A.5 Taksa e kalimit të së drejtës së pasurive të paluajtshme

Kjo lloj takse përlllogaritet nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në cilësinë e agjentit tatimor, i cili përfiton 3% të shumës së arkëtuar në bashkëpunim me Bashkinë Mirditë.

Kjo taksë vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në momentin e kalimit të pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme para kryerjes së regjistrimit në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës është sipërfaqja e ndërtimit të cilës i transferohet pronësia. Niveli i taksës është në lekë për m² të bazës së taksës. Niveli i taksës përcaktohet si përqindje dhe është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij. Vlera e taksës përcaktohet si lekë/m².

Ndërtesa banimi: 100 lekë/m²

Ndërtesa për tregti dhe shërbime: 300 lekë/m²

Ndërtesa të tjera: 200 lekë/m²

Zyrat e regjistrimit të pasurisë nuk bëjnë çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet me vërtetimin e bashkisë për pagesën e taksave nga data në fuqi e ligjit (ndryshuar me ligjin 10146 datë 28.09.2009).

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen e kësaj takse është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mirditë, në cilësinë e agjentit tatimor, i cili përfiton 3% të shumës së arkëtuar në bashkëpunim me sektorin e tatim taksave si strukturë e ngarkuar për arkëtimin e kësaj takse.

B. TAKSAT E NDARA

Taksat e ndara janë taksa që vilen nga agjentë të tretë dhe kalojnë sipas ligjit përqindjet sipas bashkive. Në taksat e ndara përfshihen:

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa e rentës minerare

Tatimi mbi të ardhurat personale

B.1 Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura paguhet nga pronari i taksës. E ardhura nga taksa mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor si agjent tatimor në bashkëpunim me sektorin e tatim taksave të Bashkisë Mirditë.

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është

25%

B.2 Renta minerare

Sipas ligjit pagesa e rentës bëhet brenda 15 ditëve të muajt pasardhës kur janë realizuar të ardhurat nga renta. Në rastin e shitjes së produktit minerar jashtë vendit, Drejtoritë e Doganave ngarkohen për arkëtimin e kësaj takse. Kur produktet minerare shiten brenda vendit, për arkëtimin e taksës mbi rentën e kryejnë degët rajonale të tatimeve. Bashkia Mirditë bën rakordimet me drejtoritë përkatëse për taksën që i takon.

Të ardhurat nga renta minerare

25%

B.3 Tatimi mbi të ardhurat personale

Tatimi mbi të ardhurat personale llogaritet mbi të ardhurat e individëve. Individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave. Individët jorezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për burimet e të ardhurave, të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore dei në fund të muajt pasardhës. Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht në përputhje me nivelin e të ardhurave.

Të ardhurat nga tatimi i të ardhurave personale 2%

C. TARIFAT VENDORE

Tarifat vendore janë të ardhura që pushteti lokal i siguron kundrejt shërbimeve që u ofron shtetasve të karakterit administrativ dhe ekonomik. Llojet e shërbimeve mund të jenë konkrete, direkte të lidhura me subjektin ose dhe lejimi i hapësirave për të kryer shërbime. Gjithashtu në rastet kur bashkia e sheh të arsyeshme për vendosjen e një tarife që kryen shërbime për komunitetin, mund ta vendosë atë me miratimin e Këshillit Bashkiak dhe Prefekturës së Qarkut.

Klasifikimi i shërbimeve është si mëposhtë:

- Shërbimet publike (shërbimet që bashkitë ofrojnë në kuadër të funksioneve të reja të transferuara)
- Të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore
- Dhënien e licensave, lejeve, autorizimeve ose dokumenta të tjera për të cilat bashkitë kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj

- Çdo tarifë tjetër e përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara me ligj (duke i lënë hapësirë bashkive të ndryshme që në situata të ndryshme dhe shërbimeve që ofrojnë në varësi të situatës, të vendosin tarifa të përkohshme të reja)

- Të ardhura nga veprimtaritë ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, donacionet dhe ndihmat, kamatëvonesa dhe gjobat e ndryshme, etj të ngjashme me to ku përfshihen:

. Të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë

. Të ardhurat nga partneritetet privato-publike

Bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive dhe të tjera të përcaktuara me ligj. Në mbështetje të ligjit 68/2017 “Për vetëqeverisjen vendore” bashkia ka autoritet të plotë për përcaktimin e sitemit dhe nivelit të tij. Njësitë e qeverisjes vendore mund të aplikojnë tarifa për të gjitha shërbimet që rrjedhin nga ushtrimi i funksioneve të veta si mbledhja e mbeturinave, ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve, dekori, funeralet, mirëmbajtja e rrugëve rurale, shërbimi i zjarrfikësve, shërbimi i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave etj.

Në sistemin e tarifave duhet të mbahet parasysh një lidhje sa më e fortë mes tarifës së aplikuar dhe asaj të vjelur si dhe qëllimi i përdorimit të saj. Kjo do të thotë se qytetarët duhet të shohin dhe prekin efektin e tarifës së paguar prej tyre dhe të kenë përfitim të drejtpërdrejtë nga shërbimet për të cilat paguajnë. Tarifat mbi shërbimet nuk duhet të shihen vetëm si burim potencial shtesë i të ardhurave, por dhe si një informacion mbi kërkesën ndaj sektorit publik dhe mjet për ekuilibrin midis rritjes së vlerës së shërbimeve dhe kostos që duhet të paguajnë qytetarët. Pra qytetarët do të paguajnë për shërbime që përfitimi i tyre do të jetë më i madh ose i barabartë me koston shtesë të kryerjes së shërbimeve.

Nisur nga niveli dhe mënyra e zbatimit tarifat mund të jenë:

1. Tarifa direkte - kur përfaqësojnë çmimin e këtij shërbimi. Qytetarët paguajnë në varësi të shërbimit të marrë sikur janë pagesat për ujin, ndriçimin etj. të ngjashme.

2. Tarifa indirekte - kur përfaqësojnë një shumë të caktuar, pavarësisht nga shërbimi që kryhet. Këto tarifa nuk bazohen në përdorimin faktik të shërbimit. Të tilla tarifa janë tarifa mbi pastrimin e territorit dhe heqjen e mbeturinave të krijuara nga aktivitete biznesi, institucione shtetërore, apo për një banor ose familje, gjelbërimi, etj të ngjashme.

C1. Tarifa e shërbimeve publike

Tarifa e shërbimeve publike për komunitetin janë tarifat që pushteti lokal kryen ndaj qytetarëve të saj kundrejt pagesës së tarifës si psh tarifa e mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane, tarifa e gjelbërimit, tarifa e ndriçimit etj.

Subjekt i kësaj tarife janë:

- Të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, kompani apo shoqëri vendase ose të huaj që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Mirditë
- Familjet që janë të regjistruara në regjistrin e gjendjes civile të Bashkisë Mirditë
- Familjet që kanë në përdorim ndërtesa me qira, nëse jetojnë gjatë gjithë vitit apo në periudha sezonale në pronat e tyre apo që i kanë në përdorim ato.

Detyrimi i tarifës është vjetor dhe paguhet për vitin kalendarik brenda vitit kalendarik. Detyrimi llogaritet dhe paguhet për çdo familje.

Për çdo familje të identifikuar gjatë vitit kalendarik, por që ka banuar ndër vite në Bashkinë Mirditë, detyrimi për tarifën llogaritet për të paktën 5 vitet e fundit që familja është banuese dhe nuk ka paguar.

Ndërsa për familjet që janë të regjistruara rishtazi (familje që ndahen nga trangu dhe blejnë shtëpitë e tyre ose familje që vijnë me pasaportizim në gjendjen civile nga bashkitë e tjera në Bashkinë Mirditë), detyrimi lind nga momenti i regjistrimit rishtazi.

Pas pagesës së taksave dhe tarifave vjetore, familjarët pajisen me librezë ku shënohet detyrimi i paguar.

- Të gjithë bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Mirditë me seli apo nipt-e sekondare në QKB brenda territorit, ose bizneset që identifikohen nga drejtoritë e bashkisë nga kontrollet në terren për aktivitete të ndryshme.
- Institucionet shtetërore brenda territorit të Bashkisë Mirditë

C.1.1 Tarifa e shërbimeve publike për familjarët

Njësia matëse e tarifës së shërbimeve është lekë për familje në vit. Baza e tarifës është llogaritur për të patur një unifikim që ti afrohet sa më shumë kostos së shërbimit të pastrimit apo dhe shërbimeve të tjera sipas VKM nr. 318 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, sipas analizës së shërbimit të pastrimit nga sektori përkatës. Tarifave për shërbimet kryesore (pastrim, ndriçim, gjelbërim) i nënshtrohen kryesisht familjet që jetojnë në qytet dhe përfshihen fshatrat ku ka kosha për mbeturinat. Sipas kostos së shërbimit duke patur parasysh distancat e kryerjes së shërbimeve, tarifën për kategorinë familje janë:

	Pastrim	Ndriçim	Gjelbërim
Familjet në qytete	1500	300	200
Familje që kanë në përbërjen e tyre invalid	1200	300	200
Familjet me gra kryefamiljare me fëmijë nën 18 vjeç	1200	0	0
Familje me kryefamiljar invalid	1000	0	0

Pencionistë të vetmuar	1000	0	0
Familje me ndihmë ekonomike	1000	0	0

Tarifa e shërbimeve bëhet një herë në vit dhe përgjegjëse për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave.

C.1.2 Tarifa e shërbimeve publike për biznesin

Në këtë kategori përfshihen çdo subjekt (person fizik, juridik, shpk apo sha) të cilët janë të regjistruar në QKB me nipt primar apo sekondar, ose janë identifikuar nga subjektet tatimore (rajonale apo vendore) që ushtrojnë aktivitetet.

Baza e tarifës për biznesin përllogariten në bazë të llojt të aktivitetit të biznesit, xhiros vjetore dhe përfshirjes ose jo në skemën e TVSH-së, zonës ku ushtrohet aktiviteti që është përcaktuese e kostos së shërbimit. Gjithashtu mund të vendosen tarifa të përkohshme në bazë ka aktivitetit.

Këto tarifa kanë për qëllim shërbimin ndaj bizneseve, gjithashtu kompensimin e dëmit në mjedis që subjektet bëjnë ndaj qytetarëve.

Afati i pagesës për këtë kategori është me dy këste të barabarta dhe duhet të mbyllet brenda vitit kalendarik.

Data për kryerjen e pagesës për këstin e parë është data 20 qershor

Data për kryerjen e pagesës për këstin e dytë është data 20 dhjetor

Për subjektet që hapin aktivitetin rishtazi gjatë vitit kalendarik detyrimi llogaritet nga data që është regjistruar aktiviteti në QKB.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e këtyre tarifave për këtë kategori është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave.

Bashkia Mirditë në bazë të përcaktimeve të mësipërme identifikon këto kategori të biznesit dhe tarifën që prekin këto kategori:

Kategoria I: Persona fizik që nuk kalojnë xhiron vjetore si biznes i vogël

Nr	Përshkrimi i aktivitetit	Lekë/vit			
		Pastrimi	Ndriçimi	Gjelbërimi	Total
1	Subjekte me aktivitet tregtimi të karakterit ushqimor, fast food, fruta perime, mish, peshku, furra buke, ëmbëltore etj. të ngjashme me to	10000	1000	1000	12000
2	Subjekte me aktivitet tregtimi si argjendari, parfumeri, rroba të përdorura, artikuj	10000	1000	1000	12000

	industrial, elektroshtëpieke etj të ngjashme				
3	Subjekte me aktivitet shërbimi si bar-kafe, parukeri, bilardo, riparime artikujsh të ndryshëm, servise celularësh apo makinash, palestra e salla fitnesi, këpucari, shërbime dekori, etj të ngjashme me to	10000	1000	1000	12000
4	Subjektet me aktivitet shitje dhe shërbime artizanale dhe subjektet ambulant.	5000	1000	1000	7000
5	Hotele, motele, bujtina dhe subjekte me bazë aktiviteti akomodimin	10000	1000	1000	12000
6	Biznese që ushtrojnë aktivitetin në objekte materiali tip llamarine, kioska ose të ngjashme me to	8000			8000
7	Tarifë pastrimi për tregun e qytetit	1000 lekë/muaj			1000

Kategoria II: Forma ligjore shpk që nuk kalojnë xhiron vjetore/persona fizikë me TVSH/profesione të lira

Nr	Përshkrimi i aktivitetit	Lekë/vit			
		Pastrimi	Ndriçimi	Gjelbërimi	Total
1	Subjekte me aktivitet këmbim valutor, exchange etj të ngjashme	10000	2000	2000	14000
2	Persona fizik me aktivitet tregtimi si supermarkete, dyqane të mëdha, restorante, etj të ngjashme	60000	3000	4000	67000
3	Transmetues televiziv, shoqëri sigurimi civil, agjenci sigurimi, etj të ngjashme me to	20000	3000	4000	27000
4	Profesione të tilla si stomatolog, farmacist, qendra të ndryshme të lidhura me mjekësinë	20000	3000	4000	27000

5	Shoqëri transporti	20000	3000	4000	27000
---	--------------------	-------	------	------	-------

Kategoria III: Biznes i madh me formë ligjore shpk, sha, etj të ngjashme

Nr	Përshkrimi i aktivitetit	Lekë/vit			
		Pastrimi	Ndriçimi	Gjelbërimi	Total
1	Subjekte të mëdha me aktivitet shërbimi si bar-restorante, sallone parukerie, thertore bagëtish, komplekse të rritjes së kafshëve/shpendëve	80000	3000	4000	87000
2	Prodhim materiale ndërtimi, tulla, tjegulla, çimento etj të ngjashme me to, kërkime dhe shpime pusi nga subjekte të licensuara	200000	3000	4000	207000
3	Agjenci shërbimi dasmash, funeralesh etj. të ngjashme	100000	3000	4000	107000
4	Firma ndërtimi për rikonstruksione të ndryshme dhe riparime të ndryshme	100000	3000	4000	107000
5	Firma ndërtimi/kantjere ndërtimi, firma të ngjashme me to	300000	3000	4000	307000
6	Institucione bankare ose njësi të tjera të ngjashme me to	100000	3000	4000	107000
7	Tregtim me pakicë karburanti, gazi etj të ngjashme	150000	3000	4000	157000
8	Autogrill me një sërë aktivitetesh si tregtim karburanti, bar kafe, market, lavazh etj me të njëjtin nipt	700000	3000	4000	707000
9	Prodhim dhe nxjerrje të nyjeve inerte	800000	0	0	800000
10	Biznese me aktivitet kërkim, zbulim, nxjerrje mineralesh dhe nënprodukteve të tyre, hidrokarbure, hidroenergjitike etj të ngjashme me to	1000000			1000000

11	Biznese me aktivitet prodhim energjie: - 1 deri në 4 mega - 5 deri në 10 mega - mbi 10 mega	100000 200000 2000000			100000 200000 2000000
12	Biznese të mëdha me aktivitet turistik si resorte apo komplekse turistike	100000	3000	4000	107000

C.1.3 Tarifa e shërbimeve publike për institucionet

Baza e taksës është llogaritur mbi koston e shërbimeve të ofruara në të gjithë njësitë dhe territorin e Bashkisë Mirditë.

Afati i pagesës për këtë kategori është me dy këste të barabarta dhe duhet të mbyllet brenda vitit kalendarik.

Data për kryerjen e pagesës për këstin e parë është data 20 qershor

Data për kryerjen e pagesës për këstin e dytë është data 20 dhjetor

Përgjegjëse për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave.

Tarifat e shërbimit për institucionet janë:

Nr	Përshkrimi i aktivitetit	Lekë/vit			
		Pastrimi	Ndriçimi	Gjelbërimi	Total
1	Qendra shëndetësore	10000	1000	1000	12000
2	Degë vendore në varësi ose jo të drejtorive rajonale	20000	2000	2000	24000
3	Institucione dhe drejtori jo në varësi rajonale si psh spitali etj të ngjashme to	100000	2000	2000	104000
4	Institucione të tjera që nuk përmenden më lart	30000	2000	2000	34000
5	OJF/ Institucione fetare të ndryshme	20000	2000	2000	24000

C2. Tarifa për mjetet e transportit

Tarifa për mjetet e transportit arkëtohet për çdo mjet në inventar të subjektit fizik apo juridik për aktivitetin që kryen. Shoqëritë e transportit që janë me aktivitet të regjistruar në QKB, paguajnë dhe tarifën si biznes kur kanë dhe aktivitete të tjera në përshkrim. Në rastet kur aktiviteti është

vetëm për transport, aplikohet vetëm tarifa e pastrimit dhe tarifa për licensën ose certifikatën e transportit.

C.2.1 Tarifa e pastrimit për çdo mjet transporti sipas kategorisë paraqitet si mëposhtë dhe llogaritet në lekë/vit:

- Taksi 4+1	5000 lekë/vit
- Taksi 8+1	8000 lekë/vit
- Autobusa 9-30 vende	10000 lekë/vit
- Autobusa 30-52 vende	15000 lekë/vit
- Kamion 1.5-3.5 ton	5000 lekë/vit
- Kamion 8.1-14	20000 lekë/vit
- Kamion mbi 14 ton	30000 lekë/vit
- Autovinç 1-14 ton	10000 lekë/vit
- Autovinç mbi 14 ton	20000 lekë/vit
- Makineri ngarkimi	10000 lekë/vit
- Të tjera mjete	15000 lekë/vit

C.2.2 Tarifa për dhënie liçence, certifikatë transporti dhe autorizime të ndryshme

Tarifat për liçencat dhe certifikatat janë të bazuara në udhëzimin nr. 15 datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor”, udhëzimit nr.5627 datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor për udhëtarët brenda vendit” (i ndryshuar).

Liçencat

Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetase	75000 lekë/5 vjet
Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetase	75000 lekë/5 vjet
Liçencë për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	15000 lekë/5 vjet
Liçencë për agjenci ndërkombëtare	40000 lekë/5 vjet
Liçencë për transport udhëtarësh me taksi	20000 lekë/5 vjet
Liçencë për transport mallrash për të tretë/me qira brenda vendit	8000 lekë/vit

Certifikatat

Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetase	1500 lekë/mjet/vit
Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetase	1500 lekë/mjet/vit

Çertifikatë për transport mallrash për të tretë/me qira brenda vendit	2000 lekë/kapacitet
Çertifikatë për transport mallrash për vete brenda vendit	2000 lekë/kapacitet

C3. Tarifa për shërbime të ndryshme me leje nga bashkia

Objekt i kësaj tarife janë ato aktivitete që detyrimisht duhet të plotësojnë disa kushte përpara se ato të ushtrojnë aktivitetin.

Lejet jepen nga bashkia pasi të jenë kontrolluar zbatimi i kushteve të përcaktuara dhe dokumentacioni të jetë i plotë.

Leje për treg privat	10000 lekë/vit
Leje për evente ose funerale	10000 lekë/vit
Leje për subjekte që krijojnë zhurma	10000 lekë/vit
Leje për ushtrim aktiviteti me orar të zgjatur	5000 lekë/muaj
Leje për aktivitet shërbimi 24 orë	10000 lekë/muaj
Leje për organizim spektakle, panairë etj të ngjashëm	3000 lekë/muaj
Leje të ndryshme jo të përmendura lart	10000 lekë/vit/shërbim

Për tu pajisur me leje si fillim bëhet kërkesa adresuar sipas drejtorive përkatëse në varësi të saj. Pas plotësimit të kushteve bëhet pagesa e lejes në bankat e nivelit të dytë dhe mandati i pagesës paraqitet në Bashkinë Mirditë. Leja merret vetëm pasi të paraqitet mandati i pagesës së kryer.

Afati i pagesës së lejes është deri në 3 ditë nga marrja e faturës për arkëtim nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.

C4. Tarifa e parkimit

Hapësira për parkim i jepet subjektit fizik ose juridik që ushtrojnë aktivitet. Subjekti mund të jetë taksi, shoqëri autobusash, mjete për furnizim, ose aktivitete të ngjashme me to. Për taksitë dhe autobusat e linjave ndërqytetase vendi i parkimit është i caktuar dhe i miratuar.

Për subjektet tregtare dhe të shërbimeve hapësira për parking jepet pasi është shqyrtuar kërkesa e bërë nga subjekti nëse i takon vendi si parking ose jo nga Drejtoria e Zhvillimit të Territorit. Nëse subjekti plotëson kushtet që ti miratohet vendi i parkingut, atëherë subjekti bën pagesën për tarifën e parkingut dhe leja lëshohet nga sektori i transportit.

Leja për parking jepet në përputhje me dispozitat e qarkullimit rrugor.

